



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-050
Prishtinë, më 3 dhjetor 2018, në orën 15:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 DHJETOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Muferra Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Armend Zemaj, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerand Stavileci dhe Avni Bytyqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Ambasada Amerikane: Adem Gashi,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Caktimi i datës për vazhdimin e seancave Plenare, të filluara më 13 shtator, më 18, 31 tetor, 2, 7 dhe 23 nëntor 2018,
2. Përgatitjet për seancë plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Vazhdimi i seancave plenare

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të filluara më 13 shtator, më 18, 31 tetor, 2, 7 dhe 23 nëntor 2018.

Kryesia, me propozim të kryetarit, vendosi që seancat plenare, t'i vazhdojnë punimet të martën, më 4 dhjetor 2018, në orën 17:00, me këtë:

Rend dite

1. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 13 shtator, 18, 31 tetor, 2, 7 dhe 23 nëntor 2018:

- 1. Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës,*
- 2. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,*
- 3. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,*
- 4. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës,*
- 5. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,*
- 6. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,*
- 7. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-038 për shërbimet postare,*
- 8. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,*
- 9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,*
- 10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017,*
- 11. Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore,*

12. *Votimi për shkarkimin e z. Shqipërim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare,*
13. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë,*
14. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,*
15. *Votimi për emërimin e kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,*
16. *Votimi i raportit vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë për vitin 2017,*
17. *Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,*
18. *Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,*
19. *Votimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017,*
20. *Votimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2017,*
21. *Votimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala,*
22. *Votimi i kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, sipas kërkesës së GP të PSD-së.*

II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 23 nëntor 2018:

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,*
4. *Interpelanca e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga GP i PSD-së, në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës,*
5. *Votimi në parim i Projektligjit për peticione,*
6. *Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,*
7. *Votimi në parim i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,*
8. *Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*
9. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për katër (4) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,*
10. *Përzgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

3. Përgatitjet për seancë plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet formale për shqyrtim në seancë e re plenare të radhës.

Pas diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që në ditëve në vijim, Kuvendi t'i mbajë dy seanca plenare:

I. Seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 6 dhjetor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet biocide,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Odën e Arkitekteve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës,*
8. *Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017,*
9. *Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017,*
10. *Emërimi i një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
11. *Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.*

II. Seanca e veçant plenare, të mbahet të premten, më 14 dhjetor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Ministrinë e Mbrojtjes,*
2. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës,*
3. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.*

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. *Vendimi i Presidentit për kthimin e Ligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi vendimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, që ta shqyrtojë Vendimin e Presidentit për kthimin e Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit

në organizata joqeveritare për rishqyrtim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, në afatin prej dy javësh.

2. Procedimi i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

3. Kërkesa e deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë nënshkrues, për debat parlamentar në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributëdhënës

Kryesia vendosi që kërkesa e lartshënuar të radhitet në rend dite të seancës plenare të radhës, pas datës 14 dhjetor 2018.

4. Kërkesa e deputetit Faton Topalli, për Debat parlamentar, në lidhje me mosekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. KI 08/09, datë 17 dhjetor 2010, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-799, dt. 19 mars 2014, Vendimit të Qeveris së Republikës së Kosovës, nr. 08/186, datë 29 prill 2014 i hyrë në fuqi më 12 maj 2014 dhe të dy (2) udhëzimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. C-V-14-4099 dhe nr. C-V-14-4332, datë 13 qershor 2014

Kryesia vendosi që kërkesa e lartshënuar të radhitet në rend dite të seancës plenare të radhës pas datës 14 dhjetor 2018.

5. Kërkesa e deputetit Korab Sejdiu për debat parlamentar lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti

Kryesia vendosi që kërkesa e lartshënuar të radhitet në rend dite të seancës plenare të radhës pas datës 14 dhjetor 2018.

6. Kërkesa e deputetit Naser Rugova për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel (Belgjikë)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Naser Rugova, i lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej 3 - 6 dhjetor 2018.

7. Kërkesa e deputetes Emilija Rexhepi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Cyrih (Zvicër)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Emilija Rexhepi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Cyrih (Zvicër), prej 21 - 25 dhjetor 2018.

8. Kërkesa e Shoqatës së prindërve “Më përkrahë Mitrovicë” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqata e prindërve “Më përkrah Mitrovicë”, me seli në Mitrovicë, mbështetet financiarisht në shumën prej 4,950 euro për financimin e projektit “Unë Prindi”, që ka për qëllim ofrimin e shërbimeve për fëmijët me të meta në zhvillim, fëmijët me nevoja të veçanta dhe mbështetje për prindërit.

9. Njoftimi i kryetares së Komisionit për Integritet Evropian lidhur me realizimin e vizitës zyrtare në Austri (Vjenë)

Kryesia u njoftua me shkrim nga kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, znj. Blerta Deliu-Kodra, për vizitën zyrtare të realizuar nga një delegacion i këtij Komisioni, në Vjenë (Austri), nga 18 - 20 nëntor 2018.

5. Pika shtesë

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar të delegacionit katër (4) anëtarësh në Hamburg (Gjermani)

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e katër (4) deputetëve: Vjosa Osmani-Sadriu, Doruntinë Maloku-Kastrati, Armend Zemaj dhe Arben Gashi, për lejimin e udhëtimit zyrtar për të marrë pjesë në Kongresin Ndërkombëtar të Partisë Unioni Kristian

Demokratik (CDU) të Gjermanisë, i cili do të mbahet në Hamburg (Gjermani) nga 6 - 8 dhjetor 2018.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan: përfaqësuesi i GP të LDK-së, deputeti Armend Zemaj; kryetari i GP të Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, dhe kryetari i GP të PSD-së, Dardan Sejdiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, përfaqësuesi i GP të LDK-së, deputeti Armend Zemaj, në emër të parashtruesve, e tërhoqi kërkesën e lartshënuar.

2. Kërkesa e për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Kryetarit të Grupit të Miqësisë Kosovë - SHBA në Kuvendin e Republikës së Kosovës, z. Memli Krasniqi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili do të jetë pjesë e delegacionit të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, në vizitën zyrtare, që do të realizohet prej 5 - 13 dhjetor 2018.

3. Kërkesa për lejimin e pjesëmarrjes në mbledhjen VI të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Anëtarëve të delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë: Memli Krasniqi, Visar Ymeri, Albulena Haxhiu, Glauk Konjufca, Vjosa Osmani-Sadriu, Armend Zemaj, Arben Gashi, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Time Kadrijaj, Bilall Sherifi, Adem Hoxha dhe Danush Ademi u lejohet udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francës), prej 13 - 15 shkurt 2019.

4. Strategjia për Informim dhe Komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Strategjia për Informim dhe Komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës u është shpërndarë nënkryetarëve të Kuvendit dhe kjo strategji në mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit do të shqyrtohet dhe miratohet.

5. Kërkesa e kryetarit të GP të LDK-së, z. Avdullah Hoti, për përfaqësimin e këtij grupi në delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Kryesia vendosi që kërkesën e lartshënuar ta shqyrtojë në mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale